



Data: 05.04.2019

Ref.: 562/19D

Bazuar në nenin 7, dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), nenin 47 dhe 131 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren mbi punën e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Nr. 621/18D, datë 12.06.2018, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 66-të, të mbajtur më 27 mars 2019, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa Nr.442/19H, datë 18.03.2019 e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, si e bazuar.
- II. Ndryshohet pika I (një) e vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Nr.145/19D, datë 05.02.2019.
- III. Anulohet tërheqja e akreditimit sipas pikës I (një) të vendimit të KSHC-së Nr.145/19D, datë 05.02.2019 për programet e studimit:
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe);
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën boshnjake), dhe
 - Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën turke).
- IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së Nr.145/19D, datë 05.02.2019 mbetet e pandryshuar.

Arsyetimi

KSHC me vendim Nr. 145/19D, datë 05.02.2019 ka tërhequr akreditimin e programeve si me poshtë: Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe); Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën boshnjake); Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën turke), dhe Shkencat Kompjuterike Teknologji Komunikimi, MSc 120 ECTS.

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të KSHC-së Nr.145/19D, datë 05.02.2019. Ankesa është dorëzuar në AKA me datë me datë 18.03.2019. Kjo ankesë është trajtuar duke u bazuar në Neni 128 (Adresimi i ankesës) dhe 131 (Procedura e shqyrtimit të ankesës

nga organi kompetent publik) të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016).

Përmes kësaj ankesa, Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren ka parashtruar faktet relevante dhe ka ofruar dëshmi rreth kualifikimit dhe fushës së studimit për stafin akademik për programet e studimit, Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe), i cilat kanë qenë objekt i trajtimit me vendimin e KShC-së Nr.145/19D, datë 05.02.2019.

Te gjitha dëshmitë e ofruara në ankesë janë trajtuar dhe vlerësuar në mbledhjen e 66-të të KShC-së, të mbajtur me 27 mars 2019, dhe në fund, KShC erdhi në përfundim që ankesa është e bazuar, dhe që stafi akademik i prezantuar përmes ankesës për programin e studimit, Programi Fillor, BA, 240 ECTS (në gjuhën shqipe), i plotësojnë kushtet për të qenë bartës të programit të studimit, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Bazuar në nenin 26 pika 5.3.10 e UA për Akreditim "Programet e studimit në gjuhën e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri me tani, të cilat kanë mundësi të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e ofruara në gjuhën shqipe, me kushte që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitete vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA".

Meqenëse dispozita e referuar me lartë i lejon ofrimin e programeve në gjuhën minoritare edhe pa stafin akademik me gradën Dr.sc. paralelisht me programin në gjuhën shqipe, KShC vendosi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, brenda afatit prej 30 ditësh nga momenti i pranimit të këtij vendimi. Ky vendim është përfundimtar, dhe iniciimi i procedurave gjyqësore nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren;
- MASHT-it, dhe
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

